



# UDHËZUES PËR MEDIAN

MBI RAPORTIMIN E ABUZIMIT  
DHE NEGLIZHENCËS NDAJ FËMIJËVE

Tiranë, 22 Mars 2013

**Në raportimin e rasteve të krimeve ndaj fëmijëve, të rasteve të keqtrajtimit, abuzimit apo neglizhencës së fëmijëve, gazetarët duhet të jenë të ndërgjegjshëm, të drejtë dhe të saktë në përdorimin e gjuhës, terminologjisë, dhënies së informacionit së përshtatshëm dhe tregimit të ndjeshmërisë së tyre njerëzore.**

**Një gazetar profesionist, kur raporton për të tilla raste duhet ta vendosë veten në “këpucët” e atyre që janë viktimë, duke pyetur veten sesi do të donte që fëmijët e tij/saj apo ai/ajo të trajtohej nga media? Si duhet të paraqitet informacioni që ai të ndihmojë prindërit dhe fëmijë që këto situata të mos përsëriten dhe që institucionet publike të japin llogari për punën e tyre?**

Ky udhëzues kërkon t’ju vijë në ndihmë gazetarëve dhe mediave në Shqipëri në përmbushjen e sfidave të përditshme për t’i shërbyer interesit të informimit publik pa cënuar privatësinë, dhimbjen dhe vuajtjen e viktimave dhe familjarëve të tyre.

Ky udhëzues është një ndihmë që Qendra për Mbrotjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA) dhe ALO 116-Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijët, duan t’i japin të gjithë gazetarëve dhe organizatave të mediave në pasqyrimin e përshtatshëm dhe objektiv të krimeve seksuale, dhunës, abuzimit apo neglizhencës së fëmijëve.

Duke punuar me mediat në mënyrë konstruktive do të ishte në të mirë të mbrojtjes së fëmijëve në shoqërinë tonë përmes ndërgjegjësimit, si dhe duke kërkuar përmirësimin e praktikës nëpërmjet promovimit të këtij mirëkuptimi.

## *Qëllimi*

Ky udhëzues është një përmbledhje e praktikave të mira dhe tregon qartë nevojën për përmirësimin e komunikimit ndërmjet profesionistëve dhe publikut dhe mënyrën se si të mbeshteten më mirë fëmijët.

Ky udhëzues ofron informacion për gazetarët rreth mbrojtjes së fëmijëve dhe mbështet bashkëpunimin ndërmjet medias dhe profesionistëve që punojnë me/për fëmijët që së bashku të punojnë që tema të ndjeshme si abuzimi dhe neglizhimi i fëmijëve, krimet seksuale etj, të raportohen në mënyrë që të ndihmojnë publikun që t'i kuptojë më mirë këto çështje.

## *Fakt*

**Shumica e fëmijëve abuzohen dhe dhunohen nga njerëz të cilët i njohin ata dhe kanë një pozitë besimi ose kontrolli mbi ta.**

## *Thënie për rolin e gazetarisë*

Gazetaria e informuar, e ndjeshme dhe profesionale është një element kyç në çdo strategji të medias për përmirësimin e cilësisë së raportimit në lidhje me çështjet e të drejtave të njeriut dhe shoqërisë.

Sfidat e përditshme të gazetarëve dhe organizatave të mediave ndjehen veçanërisht në mbulimin e çështjeve që kanë të bëjnë me fëmijët dhe të drejtat e tyre.

(Federata Ndërkombëtare e Gazetareve 2002)

## 1. Hyrje

Arsyeja për përmirësimin e besimit të publikut në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve nuk është vetëm për marrjen e një mesazhi nga të gjithë, por për marrjen e një mesazhi strategjik për të përmirësuar mënyrën e funksionimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.

**Media luan një rol kyç në raportimin e abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve dhe në funksionimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. Mbulimi mediatik ndihmon për të rritur ndërgjegjësimin rreth kësaj çështjeje me interes të madh publik. Media ka një rol të rëndësishëm në parandalimin e dhunës duke ushtruar presion dhe kërkuar llogari nga agjensive politikë-bërëse.**

Megjithatë çdo pasqyrim në media të situatave apo ngjarjeve që përfshijnë vdekjen ose lëndimin e një fëmije duhet të respektojë të drejtat dhe dinjitetin e fëmijëve dhe familjeve të përfshira.

Profesionistët që përfshihen në këto çështje punojnë në një mjedis ku çështjet ligjore dhe etike janë të lidhura ngushtë me konfidencialitetin. Ata duhet të marrin në konsideratë përfshirjen e familjarëve dhe prindërve për ta bërë materialin të disponueshem dhe aspektet ligjore të cilat përfshijnë angazhimin e komenteve publike.

## 2. Cili është realiteti i përballjes së fëmijëve me abuzimin dhe neglizhimin?

Vdekja e një fëmije është një ngjarje e rrallë dhe vdekja e një fëmije nga abuzimi ose neglizhimi është akoma më e rrallë. Sipas statistikave dhe praktikave në Europë gjatë 40 viteve të fundit numri i fëmijëve që vdesin nga abuzimi dhe neglizhimi është ulur ndjeshëm, si rezultat i rritjes së vetëdijes publike dhe ngritjes së sistemeve të përgjegjshme për mbrojtjen e fëmijëve.

Pavarësisht përpjekjeve pozitive në ndërtimin e sistemeve të fuqishme për mbrojtjen e fëmijëve vdekja e fëmijëve nga incidentet nuk mund të parashikohet dhe nuk mund të parandalohet. Megjithatë profesionistët e kanë për detyrë që të reflektojnë rreth mënyrës se si duhet që të mbështeten prindërit që të kujdesen për fëmijët dhe si profesionistët duhet të punojnë sëbashku për t'i krijuar një mjedis të sigurtë fëmijëve kur kemi të bëjmë me familje që përjetojnë vështirësi dhe probleme.

## 3. Sa e vështirë është për të mbrojtur fëmijët nga dëmtimi?

Gjithkush ka një rol për të luajtur në krijimin e një mjedisi të sigurtë për fëmijët, duke përfshirë prindërit, kujdestaret, mësuesit, profesionistët që punojnë me/për fëmijët dhe komunitetin në tërësi. Çdo ditë stafet shëndetësore, të kujdesit social, arsimit dhe drejtësisë kanë të bëjnë me vendime dhe fakte rreth rreziqeve që i kanosen fëmijëve dhe marrjen e masave të duhura për të mbrojtur fëmijët nga ekspozimi ndaj këtyre rreziqeve. Gjykim i kujdesshëm duhet të ushtrohet në balancimin e të drejtës së prindërve për t'u kujdesur për fëmijën e tyre së bashku me të drejtën e fëmijës për të qenë i sigurt.

#### 4. A duhet që profesionistët e kujdesit social dhe shëndetësor të flasin në media?

Ndërsa profesionistët e kujdesit social dhe shëndetësor do të donim të flisnin lirshëm rreth rasteve, ata janë shpesh të kufizuar nga çështjet e konfidencialiteti dhe ndjeshmërive të tjera:

- Në Shqipëri është e lehtë që të identifikohen fëmijët dhe familjet e ekspozuara ndaj abuzimit dhe neglizhimit dhe kjo e bën çështjen shumë të vështirë për të folur publikisht për rastet individuale.
- Në një çështje mund të jëne përfshirë dhe fëmijë të tjerë apo motra dhe vëllezër apo ekzistojnë gjykime të arsyeshme për të mbrojtur të drejtat dhe anonimatit e familjes.
- Nëse procedurat e tjera ligjore, sidomos të kujdestarisë ose procedimeve penale janë duke u zhvilluar, komentet dhe reagimet publike mund të dëmtojnë ose rrezikojnë çështjet dhe shkelin rregullat ligjore dhe etike për të mos e identifikuar fëmijën.
- Komunitetet shfrytëzojnë rastin për t'u përgjigjur me forcë dhe në mënyrë agresive ndaj disa rrethanave, të cilat përfundimisht ndikojnë tek familjet, ku fëmijët mund të jenë të abuzuar.
- Në disa rrethana prindërit/prindi mund të kthehet, në bazë të përcaktimeve që i atribuohen, në një të rritur të rrezikuar. Media duhet të jëtë e vetëdijshme për përfshirjen prindërve në intervista sidomos kur fëmija është i identifikuar ose i identifikueshëm.

Është e rëndësishme që media të jetë plotësisht e informuar rreth çështjeve më të gjera shoqërore, të cilat mund të rënditen të parat, si rezultat i rasteve individuale dhe fushave publike. Gazetarët duhet të krijojnë një fotografi të plotë të ngjarjeve dhe situatave për t'iu dhënë mundësinë që të bëjnë pyetjet e duhura dhe të japin përgjigje kuptimplota. Profesionistët që punojnë në fushën e shërbimeve shoqërore janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e rasteve individuale nga komentet publike, prandaj duhet të përpiqen kurdo që është e mundur t'ju ofrojnë gazetarëve informacion si: statistika, detaje të përgjithshme dhe informimacione për të ndihmuar në të kuptuarit dhe të raportuarit e çështjeve të tilla.

Informacionet mund të merren edhe nga individët që përfaqësojnë organizatat e fëmijëve, shoqëria civile dhe nga ekspertët dhe profesionistët të fushës. Kjo mundëson debatin për përmirësimin e sistemit dhe gjendjes në të cilën ndodhen të drejtat e fëmijëve dhe institucionet që punojnë për mbrotjen e të drejtave të fëmijëve.

#### 5. Roli i gazetarëve

Raportimet e gazetarëve ndonjëhere mund të mos jenë të goditura, të drejpërdrejta dhe ndoshta jo mikluese për profesionistët e përfshirë në kujdesin ndaj fëmijëve. Raportimet nga gazetarët duhet të përcillen me kujdes, të jenë të mbështetura plotësisht në prova dhe duhet të marrin parasysh çdo veprim ligjor. Mbulimi nga disa media për një ngjarje mund të jetë i shkurtër ndërsa disa të tjera i japin më shumë kohë dhe hapësirë artikullit të tyre rreth ngjarjes. Është në interes të publikut që çështjet shqetësuese të lidhura me raste individuale të gjejnë më shumë hapësirë dhe të jenë në plan të parë të kronikave të gazetave, radiove dhe TV.

## 6. Raportimi pozitiv i medias

Media luan një rol konstruktiv në rritjen e ndërgjegjësimit të prindërve dhe të rinjve për rreziqet e mundshme të veprimeve të caktuara dhe rolin e profesionistëve e shërbimeve në përgjigje të nevojave të fëmijëve dhe familjeve të tyre.

Edhe Media në Shqipëri ka krijuar eksperiencë pozitive duke bashkëpunuar me organizatat e Gazetarëve, me ato që punojnë për të drejtat e fëmijëve, si dhe agjencitë e zbatimit të ligjit. Mediat kanë qenë në gjendje të ndajnë informacion në lidhje me individët të cilët mund të paraqesin një rrezik të dëmtimit serioz për publikun. Në raste të tjera mediat kanë dhënë një kontribut nëpërmjet hapjes së debateve për çështje të rëndësishme të interesit publik.

Mbulimi mediatik përforcon mesazhin se dhuna dhe abuzimi ndaj fëmijëve mund të vijë me shpesh nga persona të cilët i njohin se sa nga të panjohurit. Dhënia e përgjegjshme e mundësisë së viktimave të abuzimit për të folur rreth eksperiencave të tyre mund të inkurajojë të tjerët që ndodhen në situata të ngjashme të kërkojnë ndihmë.

## 7. Promovimi i angazhimit të medias

Angazhimi i agjensive publike me median në raportimin e abuzimit dhe neglizhencës ka përfitime potenciale edhe kur agjencitë e kujdesit ndaj fëmijëve janë të shqetësuara për kritikën që mund t'ju bëjë media në drejtim të tyre. Bashkëpunimi do të jetë më i mirë nëse për një çështje abuzimi dhe neglizhimi agjencitë do të japin informacionin duke:

- identifikuar një person për të komunikuar me mediat dhe për të menaxhuar çdo kërkesë për informacion;
- janë pro-aktive në shkëmbimin e informacionit me mediat, jo vetëm duke reaguar ndaj kërkesave për informacion apo koment;
- qenë të qarta për kufijtë e konfidencialitetit në komentet mbi një rast të veçantë apo incident;
- shmangur deklaratat e tipit "no comment" në përgjigje të kërkesave për informacion apo komente;
- përdorur kërkesat e gazetarëve si një mundësi për të edukuar dhe për të informuar publikun e gjerë mbi abuzimin dhe neglizhencën ndaj fëmijëve;

### Disa parime themelore janë:

1. Organet publike +duhet të jetë të hapura dhe transparente në ushtrimin e funksioneve të tyre;
2. Të zgjedhurit në funksione publike duhet të japin llogari për kryerjen e detyrave të tyre ndaj qytetarëve;
3. Stafi i institucioneve publike ka të drejtën dhe duhet të jetë i lirë nga presionet administrative, për të dhënë llogari dhe informacion për publikun;

4. Familjet kanë të drejtë për privatësi pas lëndimit ose vdekjes për shkaqe serioze të një anëtari të familjes së tyre.
5. Informacioni në lidhje me vdekjen apo lëndimet serioze të një fëmije duhet të trajtohet me ndjeshmëri të madhe dhe në respekt të plotë të anëtarëve të tjerë të familjes;
6. Në intervistat dhe raportimet për fëmijët, një vëmendje e veçantë duhet t'i dedikohet të drejtës se çdo fëmije për privatësi dhe konfidencialitet. Mendimet dhe opinionet e tij duhet të dëgjohen. Fëmija duhet të marrë pjesë në vendimet që ndikojnë ndaj tij dhe ai duhet mbrojtur nga dëmtimet që mund t'i ndodhin në të ardhmen dhe që mund të jenë të lidhura me stignën apo situatën ku ai ndodhet.
7. Konsideratë dhe kujdes i lartë duhet t'i kushtohet fëmijës gjatë çdo procesi që ai do ndjekë, si në polici, prokurori ashtu edhe në procedurat gjyqësore.

## 8. Udhëzime për gazetarët dhe median

Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve (2002) miratoi një sërë udhëzimesh që mbështesin arritjen e standardeteve më të larta të gazetarisë për të promovuar raportimin e çështjeve të ndjeshme që kanë të bëjnë me fëmijët. Këto udhëzime përfshijnë disa këshilla për gazetarët dhe organizatat e medias, ndër të cilat mund të përmendim:

- Gazetarët dhe media në tërësi duhet të përpiqen për të arritur standardet më të larta dhe përsosmëri në aspektin e saktësisë dhe ndjeshmërisë kur raportohet mbi çështje që përfshijnë fëmijët;
- Ata duhet të shmangin përdorimin dhe publikimin e imazheve që kanë të bëjnë me fëmijën dhe jetën e tij/saj apo të japin informacione e të dhëna që janë të dëmshme për ta;
- Duhet të shmangët përdorimin i stereotipeve dhe paraqitjes sensacionale për të promovuar materiale gazetareske ku përfshihen
  - fëmijët;
- Duhet konsideruar dhe peshuar me kujdes pasojat e publikimit të çdo materiali në lidhje me fëmijët;
- Gazetarët dhe media duhet të sigurojë verifikimin e pavarur të informacionit të dhënë nga fëmijët dhe të tregojnë kujdes të veçantë për të siguruar që verifikimi të bëhet pa vënë informatorët dhe fëmijët në rrezik;

- Media dhe gazetarët duhet të shmangen nga përdorimi i imazheve seksuale të fëmijëve apo fjalëve e përshkrimeve të lidhura me to;
- Duhet përdorur metoda të drejta dhe të peshuara për marrjen e fotove, duke përfshirë edhe marrjen e pëlqimit të fëmijëve, prindërve, kujdestarëve apo të një të rrituri që është përgjegjës për fëmijën;
- Verifikoni kredencialet e çdo organizate që synon të flas për fëmijët, ose për të përfaqësuar interesat e tyre;

**Asnjëherë media dhe gazetari NUK DUHET të identifikojë një fëmijë nën moshën 18 vjeç, i cili/e cila është viktimë ose dëshmitar në rastet që përfshijnë abuzimin seksual ose forma të tjera të abuzimit apo neglizhimit.**

**Fëmija nën këtë moshë nuk duhet që të intervistohet ose fotografohet për çështje që përfshijnë mirëqënien e tij fizike, morale, mendore, shëndetësore dhe emocionale, pa pëlqimin e prindërve apo një personi të rritur që kujdeset për fëmijën.**

**Edhe në rastet kur prindërit ose kujdestarët e fëmijës japin lejen për botimin e fotove dhe Informacionit për fëmijën, gazetarët dhe media, duhet gjithmonë t'i japin përgjigje pyetjeve:**

- **Informacioni që do të jepet a e vendos në rrezik jetën apo mirëqënien e fëmijës?**
- **A vendoset fëmija në pozita diskriminuese, përjashtuese apo më pak të favorshme sesa fëmijët e tjerë?**
- **A rrezikon informacioni i dhënë apo që do të jepet të nxisë në krijimin e “kopjeve të shëmtuara” apo “kopjeve të përafërta” (copy cats) tek personat që kanë tendencën për të kryer krime apo ushtruar dhunë ndaj fëmijëve?**

## **9. Konkluzion**

Ne shpresojmë që këto udhëzime të bëjnë një pikë referimi e dobishme për gazetarët, mediat dhe institucionet publike për raportimin e kujdeshëm dhe profesional të rasteve të krimeve, abuzimit, keqtrajtimit dhe neglizhencës së fëmijëve. Mediat luajnë një rol të rëndësishëm në ngritjen dhe vendosjen e theksit në çështjet shqetësuese për mbrojtjen e fëmijëve. Megjithatë çdo proces duhet të kryhet gjithmonë në mënyrë të tillë që të garantojë ndjeshmërinë dhe respektin për fëmijët, të drejtat e tyre dhe të familjarëve të përfshirë në të tilla raste.